

# Indeksi i Çmimeve të Konsumit


## Dhjetor, 2017

**Tiranë, më 10 Janar 2018:** Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Dhjetor 2017, arriti 104,0 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Në muajin Dhjetor 2017 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 1,8 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 2,2 %.

Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2017 është 2,0 % nga 1,3 % që ishte në vitin 2016.

**Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)**




### **Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.**

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Dhjetor 2017 është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +1,13 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" kanë kontribuar me 0,45 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Transporti" kanë kontribuar me +0,13 pikë përqindje. Çmimet e grupeve "Pije alkoolike dhe duhan", "Veshje dhe këpucë", "Shërbimi arsimor" dhe "Hotele, kafene dhe restorante" kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve "Mallra dhe shërbime të ndryshme" dhe "Komunikimi" kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje secili.

**Për publikim 10/01/2018**

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



**Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Dhjetor 2016, rritja më e madhe e çmimeve vihet re në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,8 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 2,2 %, “Transporti” me 2,1 %, “Veshje dhe këpucë” dhe “Shërbimi arsimor” me nga 0,6 % secili, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,5 % secili, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 20,1 %, pasuar nga nëngrupet “peshk” me 5,5 %, “zarzavate përfshirë patatet” me 3,5 %, “mish” me 1,7 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” u ulën me 1,8 %, etj.

**Ndryshimi mujor i indeksit është +1,0 %.** Krahasuar me muajin Nëntor 2017 rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,8 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 1,3 %, grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,0 %. Çmimet e grupeve “Transporti” dhe “Shëndeti” shënuan një ulje prej 0,1 % secili.

**Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit**

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17	08-17	09-17	10-17	11-17	12-17
	<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>102,2</b>	<b>103,7</b>	<b>104,3</b>	<b>104,7</b>	<b>104,0</b>	<b>102,8</b>	<b>102,4</b>	<b>102,3</b>	<b>102,7</b>	<b>103,1</b>	<b>103,1</b>	<b>103,0</b>	<b>104,0</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	40,0	104,6	108,5	110,1	110,6	109,1	106,2	105,5	105,1	106,2	106,7	106,5	105,7	107,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,4	101,3	101,4	101,4	101,7	101,9	101,7	101,7	101,6	101,6	101,6	101,5	101,7	101,8
3	Veshje dhe këpucë	4,0	100,9	99,9	97,6	97,7	96,0	96,4	95,8	96,4	96,0	98,3	99,9	100,2	101,5
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,7	100,9	101,1	101,3	101,8	101,5	101,4	101,4	101,4	101,4	101,5	101,6	102,0	103,1
5	Mobilje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,5	100,2	100,3	100,1	99,9	99,9	99,9	99,8	99,4	99,5	99,4	99,5	99,7	100,2
6	Shëndeti	3,0	100,2	100,3	100,3	100,2	100,1	100,2	100,1	100,1	100,0	100,0	100,0	100,4	100,3
7	Transporti	6,2	99,2	99,4	98,9	99,9	100,4	99,7	99,3	99,7	100,2	100,3	100,0	101,3	101,2
8	Komunikimi	2,5	100,6	100,2	100,2	100,2	100,5	100,5	100,5	100,5	100,5	100,4	100,4	100,7	100,8
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	102,3	103,3	103,0	103,3	104,7	102,2	101,5	100,6	100,3	102,5	103,3	101,8	102,3
10	Shërbimi arsimor	2,5	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,9	101,3	101,3	101,3
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,9	100,1	100,1	100,2	100,2	100,2	100,2	100,1	100,1	100,1	100,1	100,1	100,2	100,6
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,7	103,3	103,2	103,2	103,5	103,3	103,3	103,4	103,4	103,4	103,4	103,4	103,4	103,5

**Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

Kodi	Grupet	12-16/12-15	01-17/01-16	02-17/02-16	03-17/03-16	04-17/04-16	05-17/05-16	06-17/06-16	07-17/07-16	08-17/08-16	09-17/09-16	10-17/10-16	11-17/11-16	12-17/12-16
	<b>Gjithsej</b>	<b>2,2</b>	<b>2,8</b>	<b>2,2</b>	<b>2,1</b>	<b>1,9</b>	<b>2,0</b>	<b>2,2</b>	<b>2,0</b>	<b>1,6</b>	<b>1,6</b>	<b>1,9</b>	<b>1,7</b>	<b>1,8</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,6	5,8	3,9	3,3	3,0	3,8	5,1	4,7	3,3	3,5	4,0	3,7	2,8
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,3	0,9	0,6	0,5	1,0	0,8	0,8	0,7	0,7	0,6	0,4	0,9	0,5
3	Veshje dhe këpucë	0,9	0,6	-0,4	-0,7	-2,3	-2,1	-2,5	-1,7	-2,1	-1,6	-0,4	-0,4	0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,9	0,4	0,6	1,1	0,9	0,9	0,9	1,1	1,1	1,1	1,1	0,6	2,2
5	Mobilje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	-0,3	-0,4	-0,5	-1,1	-0,9	-0,8	-0,2	-0,5	0,0
6	Shëndeti	0,2	0,2	0,2	0,1	-0,1	0,2	-0,1	0,0	0,1	-0,2	0,0	0,2	0,1
7	Transporti	-0,8	2,8	3,2	3,8	4,3	2,6	0,7	0,4	0,4	0,8	0,4	1,9	2,1
8	Komunikimi	0,6	0,2	0,2	-0,1	0,6	0,6	0,5	0,6	0,6	-0,1	0,0	0,0	0,2
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	3,1	2,8	3,2	4,5	2,0	0,6	-1,1	-1,1	0,8	2,1	0,8	-0,1
10	Shërbimi arsimor	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	1,0	0,9	0,5	0,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,1	0,1	0,2	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,2	0,5
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	3,3	3,2	3,0	3,4	3,1	3,0	3,2	3,4	3,0	0,1	0,2	0,3	0,2

**Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

Kodi	Grupet	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17	08-17	09-17	10-17	11-17	12-17
	<b>Gjithsej</b>	<b>0,9</b>	<b>1,5</b>	<b>0,5</b>	<b>0,4</b>	<b>-0,6</b>	<b>-1,2</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,1</b>	<b>0,4</b>	<b>0,4</b>	<b>0,04</b>	<b>-0,1</b>	<b>1,0</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,7	3,7	1,5	0,5	-1,4	-2,7	-0,7	-0,3	1,0	0,5	-0,1	-0,8	1,8
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,4	0,1	0,0	0,3	0,2	-0,2	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,2	0,1
3	Veshje dhe këpucë	0,3	-1,0	-2,3	0,1	-1,7	0,3	-0,5	0,6	-0,4	2,4	1,6	0,3	1,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,6	0,2	0,2	0,5	-0,3	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1	0,4	1,0
5	Mobililje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,0	0,1	-0,1	-0,2	0,0	0,0	-0,1	-0,4	0,1	-0,1	0,1	0,2	0,5
6	Shëndeti	-0,1	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,1	-0,1	0,0	-0,1	-0,1	0,0	0,4	-0,1
7	Transporti	-0,3	0,2	-0,5	1,0	0,5	-0,7	-0,4	0,4	0,5	0,1	-0,3	1,3	-0,1
8	Komunikimi	0,0	-0,4	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,2
9	Argëtim dhe kulturë	1,4	0,9	-0,3	0,4	1,3	-2,4	-0,7	-0,9	-0,3	2,2	0,8	-1,5	0,5
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,3	0,0	0,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,2	0,0	-0,1	0,3	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1

# Shpjegime metodologjike

## - Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2015.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Kjo listë është përditësuar në 332 mallra dhe shërbime nga 333 që ishte vitin e kaluar.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

## - Përkufizime

**Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)** është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve. IÇK në vitin  $t$  llogaritet me strukturën e shpenzimeve të vitit ( $t-1$ ).

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.